



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 95.
Prishtinë, më 15.04.2014 në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Hatim Baxhaku Saša Milosavljevič, Jelena Bontic, Petar Miletić, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Munguan: Lumnije Morina, Mufera Sinik dhe Glauk Konjufca.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: zëvendës avokati i popullit Basri Berisha, përfaqësuesi i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtare e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković** –kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 25.03.2014, 3 dhe 8 04.2014;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen nga Zhurma, me amendamente të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
4. **Miratimi i Draft-Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/I-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës;**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja– konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 25.03.2014, 3 dhe 8 04.2014.

Kryesuesja - konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 25.03.2014, 3.04.2014 dhe 8.04.2014, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen nga Zhurma, me amendamente të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;

Kryesuesja- paraqiti për shqyrtim Projektligjin për mbrojtjen nga Zhurma me Raport amendamente të Komisionit Funkcional dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në përfundim i cili do t'i dërgohet Komisionit Funkcional.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen nga Zhurma dhe ka konstatuar se nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Miratimi i Draft-Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/I-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës;

Kryesuesi- Ajo tha se kanë kaluar dy vite që grupi punues ka punuar lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit nr. 03/I-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës.

Sot do të diskutohet lidhur me Draft-Raportin dhe njëherit kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo vërejtje të cilat do të përfshihen në Raport.

Ajo tha se kryetar i grupit punues për monitorimin e zbatimit të Ligji, ka qen Elmi Reçica dhe kërkoi nga ai që të elaboron lidhur me hartimin e Draft-Raportit.

Elmi Reçica- tha se sot do të diskutohet lidhur me Draft- Raportin e monitorimit dhe zbatimit të Ligjit nr. 03/I-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës. Është e vërtet që procedura e monitorimit të këtij ligji ka filluar para një kohe të gjatë por ky raport i përgjigjet kohës dhe rrethanave në të cilat gjendet Kosova Konsideron se Raporti ndërthet të gjitha aktivitetet të cilat janë zhvilluar nga takimet e grupit punues dhe në mbështetje të stafit administrativ të komisionit dhe të atyre që kanë pasur vullnet të mirë.

Grupi Punues ka bashkëpunuar me institucionet relevante dhe ka identifikuar pyetjet specifike ligjore, janë kërkuar informacionet zyrtare dhe raportet nga qeveria, kuvendet komunale, janë realizuar vizitat në terren, është mbajtur Dëgjimit Publik. Të gjitha këto aktivitete janë inkorporuar në përpilimin e raportit me rekomandime dhe të gjeturat.

Raporti nuk është definitiv, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të ofrohen propozime apo vërejtjet e tyre të cilat janë të mirëpritura për finalizim të raportit, para se të dërgohet në kryesi.

Albert Kinolli - fillimisht i falenderoi kryesuesin e grupit punues dhe përfaqësuesit tjerë për kontributin e dhënë gjatë punës së monitorimit të Ligjit.

Kishte disa vërejtje, ai diskutoi lidhur për temën e takimit me ministrit Petrovic- të cilët kanë kërkuar që në afat sa më të shkurtër të rregullohet çështja e vendbanimeve jo formale dhe çështja e legalizimit të pronave për të kthyerit.

Si problem tjetër ngriti çështjen e përdorimit të gjuhëve zyrtare, ku gjuha rome është gjuhë tradicionale në KK të Prizrenit. Ne kemi insistua që gjuha rome të ketë statusin e gjuhëve në përdorim zyrtare në nivel Komunal dhe përfaqësimi në institucionet lokale dha ato qendrore.

Sa i përket teksteve shkollore, në ditën ndërkombëtare të romëve për herë të parë është prezantuar abetarja në gjuhën rome de se fëmijët tanë tani kanë mundësi të mësojnë për historinë dhe kulturën në gjuhën amtare. Shpreson se raporti do të plotësohet me propozim rekomandimet e tija.

Kryesuesja – ishte e mendimit që Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligji për Fshatin Hocë e Madhe të mos figurojnë në këtë raport pasi ende janë në fazën e monitorimit.

Sa i përket mungesës së kapaciteteve në përdorimin e nivelit të pushtetit lokal, mendon se më parë duhet të rregullohet kjo çështje prej nivelit qendror pastaj atij lokal.

Kur bëhet fjalë për kvotën e kufizuar për punësim, duhet të jemi sa më konkret nga se institucionet publikë e kanë lanë anash çështjen e punësimit të komunitetit pakicë.

Rasim Demiri- kur bëhet fjalë për komunitetin jo shumicë, për shembull kur flitet për vendet e rezervuara, thuhet 10 vende për komunitetin serb dhe 10 vende për komunitetet tjera. Vërejtja e tij ishte që edhe komunitetet tjera të emërtohen.

Elmi Reçica- theksoi se sot debatohet lidhur me draft-raportin e monitorimit të ligjit dhe ishte i mendimit që çdo sugjerim apo vërejtje të dërgohen me shkrim, dhe se të njëjtat do të inkorporohen në tekstin e raportit final. Ne jemi ata që maksimalisht llojmë të respektohen të drejtat dhe liritë e të gjitha komuniteteve të cilët jetojnë në Kosovë. Jemi në përfundim të këtij mandati dhe raporti lidhur me zbatimin e Ligjit domosdoshmërisht duhet të gjej zbatim në opinion dhe tek qytetarët Kosovarë.

Sasa Mladenovic – u ndërlidhe me fjalimin e Rasimit, në çdo ligj duhet të përfshihen me shkrim përveç komunitetit serb edhe komuniteti boshnjak, turk, goran, romë etj.

Petar Miletic- ishte i mendimit se nëse nuk do të ketë propozime me shkrim deri ditën e premte, i njëjti raport do të miratohet nga komisioni dhe do të procedohet për shqyrtim në Kryesi.

Kryesuesi – propozoi se secili nga anëtarët e komisionit deri në fund të kësaj jave, propozimet e veta mundin ti dërgojë tek stafi mbështetës i komisionit. Të njëjtat do të inkorporohen në raport dhe në mbledhjen e radhë do të votohet për miratim të raportit, lidhur me këtë ligj.

Basri Berisha – zëvendës avokati i popullit, theksoi se në fushën dhe përgjegjësit e të gjitha komisioneve parlamentare është bërë një praktik e mirë lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjeve të miratuara në Kuvendin e Kosovës.

Kur bëhet fjalë për monitorimin e zbatimit të ligjeve, shihen sa ka zbatim të tyre në praktikë.

Në rastet kur hasen mangësitë të cilat e pengojnë zbatimin e ligjit, mund të propozohet ndryshim plotësimi i Ligjit, dhe shtoi se ndërlidhet edhe me respektimin e të drejtave të pjesëtarëve të komunitetit që jeton në Kosovë.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të Ligjit për komunitete dhe pjesëtarëve të tyre, rekomandimet dhe të gjeturat janë të theksuara edhe raportin e avokatit të popullit, siç janë mungesa e kapacitetit të përkthyesve në nivel lokal e më pak në nivel qendror, çështja e mosrespektimit të shenjave topografike, literatura, arsimimi, kultura etj.

Faktikisht shihet se ka përparime në zbatimin e këtyre të drejtave por mbetet ende punë për tu realizuar. Ndoshta si pengesë janë edhe mungesa e mjeteve buxhetore, si për shembull punësimi i përkthyesve ku më pas do të dalim me përkthim në nivel më të lartë të dokumenteve zyrtare.

Përparim ka edhe me rastin e hapjes së kanalit të dytë të RTK-së në gjuhën serbe, Mirëpo me plotë të drejtë është diskutuar se duhet të jetë i mundshëm përfaqësimi i komunitetit kroat dhe atij malazez me Kushtetutë

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković